



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.126/2016

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afiete Sada dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën (NISMA), dega në Gllogoc, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në Raundin e Dytë për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogoc, në seancën e panelit të mbajtur me 21.12.2016, mori këtë:

## V E N D I M

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews, Anr.126/2016 e datës 19.12.2016, ashtu që subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim i më gjobë, në shumë prej 2,500.00 euro (dymijë e pesëqind), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës BIRN, me datën 19.12.2016, ka parashtruar një ankesë me numër Anr.126/2016, në PZAP, me të cilën pretendohet se më datë 17.12.2016, rrëth orës 18:54, në adresën zyrtare elektronike të subjektit politik Nisma për Kosovën brenda 24 orëve të heshtjes zgjedhore, që pretendohet sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik Nisma për Kosovën, ka shkelur dispozitën ligjore të nenit 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr. 03/L-73, sepse është bërë thirrje, njoftim për kohën kur do të votoj kandidati i NISMËS Isa Xhemajlaj duke cilësuar atë si kryetar të ardhshëm të Gllogocit. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur pretendimeve te parashtruar në ankesë, një fotografi. Më propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet si e bazuar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, subjekti politik Nisma për Kosovën, e informoi lidhur me ankesën Anr.126/2016 të datës 19.12.2016, të parashtruar nga BIRN, dhe e i ka dhënë mundësin që të përgjigjet ndaj ankesës së theksuar më lart.

Subjekti politik NISMA me seli në Prishtinë, brenda afatit të caktuar nga PZAP-i, ka paraqitur përgjigje në të cilën kanë theksuar se është bërë interpretim i gabuar i nenit

36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr. 03/L-73, duke theksuar se subjekti politik NISMA nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet fushate as në heshtjen zgjedhore aq më pak në ditën e zgjedhjeve. Mëtej në përgjigjen në ankesë shtojnë se mediat e ndryshme të cilat kanë përcjellur procesin zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, përmes telefonit iu janë kërkuar subjektit politik NISMA, që të iu bëhet e ditur koha e daljes në votim të kandidatit të tyre Isa Xhemajlaj. Dhe si e tillë duhet të bëhet dallimi në mes të njofimit dhe thirrjes për votim, sepse sipas subjektit politik NISMA për Kosovën, nuk është bërë thirrje për votim në asnjë rast. Me propozim për PZAP-in, që ankesa në fjalë të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që analizoj pretendimet e palëve në procedurë dhe shqyrtoj provat që gjenden në shkresat e lëndës gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

PZAP-i, vlerësoi se fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se shkrimet lidhur me kohën e votimit të kandidatit për Kryetar të Komunës së Gllogocit, nga radhët e subjektit politik NISMA - Isa Xhemajlaj, i cili postim i është shpërndarë në rrjetin social facebook duke bërë njofimin se në sa ora dhe në cilën QV do të votoj kryetari i ardhshëm i Gllogocit, e që është në kundërshtim me nenin 36 par.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton qartë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike para procesit të votimit respektivisht ne periudhën e heshtjes zgjedhore ngase me dispozitën e lartcekur ndalohet bërja në çfarëdo mënyre e fushatës, që në rastin konkret PZAP-i, ka konstatuar se me rastin e njofimit siç shihet në fotografi, është thyer heshtja zgjedhore në rastin kur është potencuar se voton kryetari i ardhshëm i Gllogocit.

Lidhur më lartësinë e gjobës të vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje si dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Me rastin e vendosjes PZAP-i, mori parasysh edhe pretendimet e Subjektit Politik NISMA për Kosovën, të paraqitura në përgjigje në ankesë, në të cilën kanë theksuar se mediat kanë kërkuar nëpërmes telefonit të njoftohen se kur do të votoj dhe ku do të votoj kandidati për kryetar, PZAP vlerëson se kjo është çështje tjetër, që nuk ndërlidhet me pretendimet ankimore ngase siç rezulton nga fotografia e lartpërmendur, është e qartë se heshtja zgjedhore është thyer në momentin kur është potencuar se voton kryetari i ardhshëm i Gllogocit. Prandaj pretendimet e

parashtruara në përgjigje në ankesë janë të pabazuar në ligj dhe nuk janë me asnë provë të argumentuar, e të cilat nuk kanë asnë ndikim për të marrë ndonjë vendim me të favorshëm për subjektin politik NISMA.

Andaj PZAP-i, duke marrë parasyshë të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik NISMA është shkelur nen 36 paragrafi 1 pika (b) i LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës është konstatuar në mënyrë të padyshimitë gjendja faktike sepse e njëjtë përmban shkrimin me përbajtjen e potencuar më lart, datën dhe orën kur dhe ku do të votojë kandidatit i subjektit politik NISMA për Kosovën, dhe se postimi i njëjtë është i shpërndarë në rrjetin social facebook, që ka rezultuar se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore.

Nisur nga të gjitha arsyet e theksuar më lart dhe bazuar në dispozitën ligjore të nenit 118 par.1 dhe 120 par.1 pika c, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.126 /2016 më datën 21.12.2016

**Kryesuesja e Panelit  
Gjilene Sylejmani**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë konform nenit 118, 4 të LZP-së.